



Për: Media të shkruara dhe elektronike  
Nga: Departamenti për marrëdhënie me publikun  
Subjekti: Grupi Parlamentar i AKR-së vizitohet fshatin Debellde

---

*Prishtinë, 03 prill 2008*

## Njoftim

Grupi Parlamentar i AKR-së vizitohet të enjten fshatin Debellde, ku u prit nga përfaqësuesit e këtij fshati.

Deputetet e AKR-së gjatë këtij takimi arritën të informoheshin nga afër për gjendjen e banorëve të kësaj pjese të Kosovës.

Kryetari i fshatit Debellde, Zymri Ilazi, duke shprehur shqetësimin për gjendjen e krijuar në këtë pjesë të Kosovës, tha se marrëveshja Serbi-Maqedoni në lidhje me këtë pjesë të Kosovës është e papranueshme. Ai shtoi se fshatarët kanë 429 ha tokë, në këtë pjesë, në të cilën nuk kanë qasje, tash e 8 vite.

Shefi i Grupit Parlamentar të AKR-së, z. Ibrahim Makolli tha se kjo vizitë është mbajtur me qëllim për t'u njoftuar nga afër me problematikën e demarkacionit të kufirit të kësaj pjese të Kosovës dhe për të dëgjuar hallet dhe problemet e fshatarëve të Debelldesë. Ai shtoi se AKR do të punoj që kjo çështje të zgjidhet vetëm në mënyrë institucionale.

Anëtari i Kryesisë së Parlamentit të Kosovës, z. Ibrahim Gashi deklaroi se AKR, ka reaguar vazhdimisht në lidhje me këtë problematik dhe se ka kërkuar për të qenë pjesë e komisionit për demarkacionin të kufijve të Kosovës. Ai shtoi se kjo problematik është mjaft komplekse dhe se AKR do të shfrytëzoj gjitha kapacitetet e saj për të çuar përpara zgjidhjen e kësaj çështje.

Zyra për informim e AKR-së